



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501740/2

Tiranë ___/___/2015

Lenda: Rekomandohet "Marrja e masave për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit të vendimit nr.77 akti datë 09.07.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Krime të Rënda Tiranë për vendosjen e masës së sigurimit "Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik" ndaj shtetasit B. H. S., dhe transferimin e tij nga mjediset e Qendrës Spitalore të Burgjeve Tiranë, në një Institucion Psikiatrik të Specializuar, jashtë sistemit të burgjeve".

Drejtuar : Drejtuesit të Prokurorisë për Krime të Rënda

Z.Adnand XHOLI

Për dijeni: Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

TIRANË

I nderuar Z. XHOLI,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi B. S., ndaj të cilit Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.77 akti datë 09.07.2015, ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit "Arrest në burg", me masë sigurimi "Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik". Nga verifikimi dhe studimi i akteve të administruara, të paraqitura nga ankuesi dhe kartelës klinike të Qendrës Spitalore të Burgjeve me nr. Statistikor 352 datë 02.09.2015, ka rezultuar se:

Shtetasi B. S., i datëlindjes 14.09.1969, është person me probleme të shëndetit mendor dhe vuan nga sëmundja e "Çrregullimit psikotik, epilepsi e gjeneralizuar".

Prokuroria e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka filluar procedimin penal nr.185 të vitit 2014, ndaj personit të dyshuar B. S., për veprën penale *“Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”* e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/c, 22 të Kodit Penal.

Në seancë gjyqësore të datës 09.07.2015, janë marrë dhe mendimet e ekspertëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore, të cilët kanë dhënë detaje të plota dhe të hollësishme për natyrën e sëmundjes, si dhe faktin se shtetasi B. S., sipas të dhënave mjekësore, vazhdon të jetë i sëmurë mendërisht duke passjellë përjashtimin ose pakësimin e zotësisë për të kuptuar. Për rrjedhojë, gjykata ka pranuar kërkesën e të dyshuarit B. S., si dhe të organit të Prokurorisë, duke marrë vendimin e sipërpërmëndur.

Në pjesën e dispozitivit të vendimit nr.77 akti datë 09.07.2015, Gjkata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka urdhëruar Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për zbatimin e kësaj mase sigurimi dhe njoftimin e menjëhershëm të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda sapo të mundësohet ekzekutimi i kësaj mase .

Duke analizuar në tërësi aktet e administruara arrijmë në disa përfundime dhe konkretisht:

Së pari: Ka qënë kërkesa e organit procedues, i cili gjatë fazës së hetimeve paraprake i ka kërkuar gjykatës zëvendësimin e masës së sigurimit *nga “Arrest në burg”* në *“Shtrim të përkohshëm në një spital psikiatrik”*.

Në nenin 46 Pika 2 të Kodit të Procedurës Penale thuhet shprehimisht se: *“Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik”*.

Po kështu në Ligjin Nr.44/2012 *“Për Shëndetin Mendor”*, miratuar në datën 19.04.2012, neni 28 përcakton Institucionet mjekësore të posaçme.

1.Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor. 2.Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar”.

Në nenin 16 të Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”*, me ndryshimet përkatëse, thuhet:*“Institucionet mjekësore të posaçme ose në seksione të veçantë në burgje ose në spitale jashtë sistemit të burgjeve shërbejnë për mjekimin e të dënuarve të sëmurë ose me shqetësime mendore ose psikike”*.

Së dyti: *Mosnxjerra* e Urdhërit nga Prokurori për zbatimin e vendimit të gjykatës vjen në kundërshtim dhe me të drejtat e njeriut të sanksionuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut datë 10 dhjetor 1948, si dhe nenin 3 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, akte ndërkombëtare të cilat personat me çrregullime të shëndetit mendor, i shikojnë si persona të paaftë e të cënueshëm. Për rrjedhojë atyre duhet t’u sigurohet trajtim i duhur mjekësor, përshtatshëm e ndihmës dhe përkujdesit mjekësor në një institucion psikiatrik të specializuar. Nga ana tjetër

ai bie ndesh dhe me nenin 15 dhe 28 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Urdhëri i ekzekutimit është akti proceduror mbi bazën e të cilit prokurori nis procedurën e ekzekutimit të vendimit penal dhe si i tillë ai parashikohet në nenin 13 të ligjit nr.8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” me ndryshimet përkatëse.

Domosdoshmëria e nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit të vendimit penal, vjen dhe nga respektimi i kërkesave të nenit 21 të ligjit të mësipërm “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, dhe faktit të njohur se Qendra Spitalore e Burgjeve ku ndodhet aktualisht shtetasi B. S., person me probleme të shëndetit mendor, është brënda sistemit të burgjeve.

Për sa sipër dhe duke gjetur se ankesa e shtetasit B. S., është e drejtë, në bazë të nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”, si dhe nenit 21 gërma “c” të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse, “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen*”,

REKOMANDOHET

“Marrja e masave për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit nga Sektori i Ekzekutimit të Vendimeve Penale pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nr.77 akti datë 09.07.2015, me qëllim kalimin e shtetasit B. S., nga mjediset e Qendrës Spitalore të Burgjeve Tiranë në një Institucion Psihatrik të specializuar, jashtë sistemit të burgjeve”.

Mbi mënyrën e shqyrtimit të Rekomandimit tonë, lutemi të vihemi në dijeni jo më vonë se 30 ditë nga dërgimi i tij, kërkesë kjo e parashikuar në nenin 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI